

32004R1138

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1138/2004 e 21 qershorit 2004 për përcaktimin e një përkufizimi të përbashkët të pjesëve kritike të zonave të kufizuara të sigurisë në aeroporte (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 221, 21/06/2004 fq. 0006 – 0007

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1138/2004 e 21 qershorit 2004 për përcaktimin e një përkufizimi të përbashkët të pjesëve kritike të zonave të kufizuara të sigurisë në aeroporte (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Komisioni i Komuniteteve Europiane

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) nr. 2320/2002 të Parlamentit European dhe të Këshillit e 16 dhjetorit 2002 që përcakton rregulla të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil [1] dhe në veçanti nenin 4 pika 2 të saj dhe pikën 2.3 germa a të Shtojcës së saj.

Duke pasur parasysh se:

(1) Në mbështetje të Rregullores (KE) nr. 2320/2002 Komisionit i kërkohet të përcaktojë një përkufizim të përbashkët të pjesëve kritike të zonave të kufizuara për arsye sigurie . Një përkufizim i tillë duhet të mbulojë të paktën ato pjesë të aeroportit ku pasagjerët që nisen për udhëtim, pas kontrollit në ekran, kanë të drejtë për të hyrë dhe ato pjesë përmes së cilave bagazhet e dorës që nisen për udhëtim, pas kontrollit, mund të kalojnë ose mund të mbahen.

(2) I gjithë personeli, përfshirë edhe ekuipazhin e fluturimit dhe pajisjet që ata mbajnë, duhet të kontrollohen përpara se t'u lejohet e drejta e hyrjes në pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë.

(3) Një përjashtim mund të lejohet për pjesët e aeroportit përmes së cilave kalojnë, pas kontrollit në ekran, bagazhet e dorës që nisen për udhëtim, nëse bagazhi është siguruar, mund të trajtohet edhe nga personeli i pakontrolluar pa cenuar nivelin e sigurisë. Duhet të merren masa për t'u siguruar që një bagazh i tillë i siguruar nuk është ngacmuar përpara se të futet në avion.

(4) Në aeroportet ku vetëm një personel i vogël ka të drejtën e hyrjes për në zonat e kufizuara të sigurisë, duhet të vendoset një ekuilibër ndërmjet nevojës për siguri dhe nevojës për efektshmëri të punës.

(5) Personelit të pa kontrolluar do t'i lejohet e drejta e hyrjes në pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë së një aeroporti, vetëm në kushtet kur ata janë gjatë gjithë kohës të shoqëruar nga një staf i autorizuar dhe i kontrolluar.

(6) Në rastet kur persona të tjerë të pakontrolluar mund të kenë pasur të drejtën e hyrjes në pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë, një kontroll sigurie i plotë duhet të kryhet për t'u siguruar që pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë nuk përmbajnë sende të ndaluara. Kur pjesët kritike nuk kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme, atëherë menjëherë përpara se ato të ripërcaktohen si të tilla, duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të plotë sigurie.

(7) Masat e parashikuara në këtë rregullore janë në përputhje me mendimin e Komitetit të saktësuar nga neni 9 pika 1 e Rregullores (KE) nr. 2320/2002,

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

1. Në aeroportet ku më tepër se 40 anëtarë të personelit mbajnë karta identifikimi të aeroportit, që u japin të drejtën e hyrjes në zonat e kufizuara të sigurisë, pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë do të jenë të paktën si më poshtë:

(a) çdo pjesë e aeroportit në të cilat pasagjerët që nisen për udhëtim, përfshirë dhe bagazhet e tyre të kabinës , pas kontrollit , kanë të drejtën e hyrjes;

(b) çdo pjesë e aeroportit përmes së cilave, pas kontrollit , bagazhet e dorës që nisen mund të kalojnë, ose që mund të mbahen, nëse bagazhi nuk është siguruar.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, çdo pjesë e aeroportit do të përkufizohet si pjesë kritike e zonave të kufizuara të sigurisë sa kohë që:

(a) pasagjerët që nisen për udhëtim, duke përfshirë bagazhet e tyre të kabinës , pas kontrollit , janë të pranishëm në atë pjesë;

(b) bagazhi i dorës që niset për udhëtim, pas kontrollit , kalon ose mbahet në atë zonë, nëse nuk është i siguruar.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, avioni, autobusi, mjeti që transporton bagazhet apo mjete të tjera të transportit ose kalimi për këmbësorët do të konsiderohen si pjesë e aeroportit.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj rregulloreje “bagazh i siguruar” do të nënkuptojë bagazhin e dorës, i kontrolluar që niset për udhëtim fizikisht i mbrojtur, me qëllim që të parandalojë futjen e ndonjë objekti.

Neni 3

Në aeroportet ku më tepër se 40 anëtarë të personelit mbajnë karta identifikimi të aeroportit që u japin të drejtën e hyrjes për në zonat e kufizuara të sigurisë, Shtetet Anëtare do të vazhdojnë të identifikojnë pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë në përputhje me nënparagrafin e dytë të pikës 2.3 germa a të Shtojcës së Rregullores (KE) nr. 2320/2002.

Neni 4

1. I gjithë personeli, përfshirë edhe ekuipazhin e fluturimit dhe pajisjet që ata mbajnë, duhet të kontrollohen përpara se t’u lejohet e drejta e hyrjes në pjesët e referuara në pikën a të nenit 1 pika 1, kudo që këto pjesë formojnë pjesë të ndërtesës së terminalit.

2. Jo më vonë se 1 janar 2006, Shtetet Anëtare duhet të kenë paraqitur marrëveshje përmes së cilave i gjithë personeli, duke përfshirë dhe ekuipazhin e fluturimit dhe pajisjet që ata mbajnë, duhet të kontrollohen përpara se t’u lejohet e drejta e hyrjes në pjesët e referuara në pikën a të nenit 1 pika 1.

3. Jo më vonë se 1 korrik 2009, Shtetet Anëtare duhet të kenë paraqitur marrëveshje përmes së cilave i gjithë personeli, duke përfshirë dhe ekuipazhin e fluturimit dhe pajisjet që ata mbajnë, duhet të kontrollohen përpara se t'u lejohet e drejta e hyrjes në pjesët e referuara në pikën b të nenit 1 pika 1.

Neni 5

Jo më vonë se 1 korrik 2009, kur bagazhi i siguruar trajtohet nga personel i pakontrolluar, duhet të merren masa për t'u siguruar që një bagazh i tillë nuk është ngacmuar përpara se të futet në avion.

Neni 6

1. Duke përjashtuar nenin 4, nuk është e nevojshme që personeli të kontrollohet përpara se të lejohet të hyjë në zonat e kufizuara të sigurisë, në rast se ata shoqërohen nga një anëtar i personelit që është kontrolluar dhe autorizuar.

Eskorta do të jetë përgjegjëse për çdo shkelje sigurie të shkaktuar nga anëtari i stafit që po shoqërohet.

2. Duke përjashtuar nenin 4, anëtarët e personelit të kontrolluar që largohen përkohësisht nga pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë, nuk është e nevojshme të kontrollohen pas kthimit të tyre, me kusht që ata të kenë qenë gjatë gjithë kohës nën vëzhgim të vazhdueshëm, mjaftueshëm për t'u siguruar që ata nuk kanë futur sende të ndaluara në pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë.

Neni 7

Pa cenuar nenin 6, në çdo rast që persona të pakontrolluar mund të kenë të drejtën e hyrjes në pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë, duhet të bëhet në këto zona një kontroll i plotë sigurie.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2004.

Kjo rregullore do të jetë detyruese në tërësinë e saj dhe do të jetë drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 21 qershor 2004

Për Komisionin

Loyola De Palacio

Zv/Presidenti

(1) GZ L 355, 30.12.2002, fq. 1.